



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GJAKOVËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gjakovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Gjakovës (KGj), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjakovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Gjakovës nuk kanë qenë në përputhje me:

Baza për konkluzion

- A1 Dobësi në menaxhimin dhe raportimin e subvencioneve ku nuk është respektuar Rregullorja MF-nr.04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve;
- A2 Parregullsi në pranimin e mallit dhe ekzekutimin e pagesave, ku për pagesën në vlerë prej 8,146€ nuk janë respektuar kushtet e kontratës;
- A3 Anashkalimi i procedurave të prokurimit për projektin- Promovimi i vlerave kulturore dhe tradicionale të komunës së Gjakovës (4,000€);
- A4 Tek kontrata kornizë, "Sigurimi fizik i objekteve të komunës së Gjakovës" është tejkaluar vlera e kontraktuar dhe vlera indikative +30%. Vlera e tejkaluar ishte prej 16,012€;
- A5 Dobësi në realizimin dhe menaxhimin e kontratës;
- A6 Menaxhim i dobët i kontratave lidhur me kryerjen e pagesave për punë të pa realizuara në vlerë 11,513€;
- A7 Mungesa e projekteve ekzekutive;
- A8 Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara;
- B1 Çmimet jo normalisht të ulëta për njësi në ofertën tenderuese;
- B2 Shpenzime shtesë si rezultat i vendimeve gjyqësore/përmbartimore në vlerë 525,777€; dhe
- B3 Vonesa në pagesën e faturave.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Vlera e prezantuar e pasurisë nën 1,000€ në pasqyra vjetore financiare për vitin 2021 ishte 1,705,745€ dhe stoku 182,317€. Komuna nuk kishte regjistruar këto pasuri në sistemin e e-pasurisë. Si alternativë, komuna për qëllime të brendshme kishte mbajtur një regjistrë të pasurisë nën 1,000€ në bazë excell, formë e modifikuar nga vet komuna. Megjithatë, komuna ka shpalosur në pasqyra financiare problemet lidhur me sistemin e-pasuria që nuk ishte funksional.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme

për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Gjakovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Gjakovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Gjakovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Gjakovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gjakovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: mospajtushmeri me rregullat tek investimet kapitale, mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere dhe pagesa me vendime të gjykatës. Përveç këtyre kemi identifikuar ç'është tjetra në menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë, përfshirë keq klasifikimin e shpenzimeve, të hyrat, menaxhimin e pasurisë, llogarit e arketueshme dhe detyrimet kontingjente. Po ashtu, procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së PFV-të të cilat kishin edhe gabime tjera, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe janë bërë korrigjimet e mundshme. Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 20 rekomandime, prej tyre 12 janë rekomandime të reja dhe tetë (8) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Dobesi në menaxhimin dhe raportimin e subvencioneve

Gjetja

Sipas Rregullores MF-Nr.04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 12, përcakton që çdo mbështetje financiare për OJQ-të duhet të shpallet përmes thirrjes publike, e cila duhet të publikohet në ueb faqen e ofruesit të mbështetjes financiare, kurse neni 23.1 Monitorimi dhe raportimi i projekteve dhe programeve përcakton se "Për secilën kontratë të lidhur, ofruesi i mbështetjes financiare cakton një zyrtar përgjegjës i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Ndërsa në pikën 2, kërkohet nga përfituesi të raporton te zyrtari monitorues, në baza të rregullta, lidhur me zbatimin e projektit/programit, sipas kërkesave të kontratës. Po ashtu Thirrja publike e datës 01.03.2021 ka përcaktuar kriteret që duhet të plotësohen nga aplikuesit e mbështetjes financiare, ku ndër kriteret e vendosura ishin: para nënshkrimit të kontratës OJQ-të duhet të paraqesin prova më vërtetim nga gjykata se personi përgjegjës i OJQ-së dhe menaxheri i projektit nuk janë në hetime për vepra penale, si dhe prova me vërtetim tatimor se OJQ nuk është në obligime tatimore.

Nga pesë (5) mostrat e testuara kemi identifikuar se:

- Në dy raste, komuna kishte ndarë subvencione OJQ-ve pa thirrje publike:
 - Mbështetje financiare në shumë prej 10,000€ për financimin e projekteve të OJQ-ve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. OJQ/klub të hembollit, kishte përfituar me propozim të kryetarit dhe me vendim ⁵ të kuvendit komunal; dhe
 - Mbështetje financiare në shumë 31,451€ të OJQ/klub të hembollit, vendimi ⁵ ishte marrë nga Kuvendi Komunal për ndarjen e mjeteve të klubit. Mirëpo, pa e informuar kryetarin e komunës dhe drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport. Kjo pagesë është bërë përmes vendimit gjyqësorë.
- Mbështetja financiare për OJQ/KFC në vlerë 7,000€, është bërë pa i plotësuar kriteret për thirrje publike (pa e sjellë vërtetimin tatimor dhe vërtetimin e gjykatës). Komuna nuk i ka obliguar as përfituesit tjerë të kësaj thirrje publike të sjellin vërtetimin tatimor dhe të gjykatës; dhe
- Në fushën e kulturës dhe sportit, tre OJQ/Klub sportiv nuk kanë dorëzuar raporte kthyes narrative.

Menaxhimi i subvencioneve në këtë mënyrë, është si pasojë e neglizhencës dhe mos monitorimit të subvencioneve.

Ndikimi

Ndarja e subvencioneve pa thirrje publike përjashton konkurrencën, transparencën si dhe ndikon në trajtimin jo të barabartë të OJQ-ve. Ndërsa mos raportimi dhe monitorimi ngrit dyshime nëse fondet janë përdorë për qëllimet e synuara dhe mund të ndikoj që drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport të mbetet pa mjete dhe të dështoj në realizimin e planit programit për mbështetje të OJQ-ve si dhe ti mundësojë OJQ/klubit ti keqpërdor mjetet.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se, financimi i OJQ-ve behet vetëm me thirrje publike, në përputhje me kriteret e vendosura si dhe për ç'do përfitues të subvencionit të caktojë zyrtar monitorues, po ashtu, të siguroj që OJQ-të dorëzojnë raporte kthyes narrative.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Parregullsi në pranimin e mallit dhe ekzekutimin e pagesave

Gjetja Sipas kontratës "Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve të KPSH-së dhe QPS-së, përkatësisht neni 1, paragrafi 1.2, pika 12 citon "faturimi duhet të jetë detaj dhe duhet të përcillet me raport mujor për gjendjen e mirëmbajtjes dhe të prezantohet procesi." Dhe pika 4 e cila citon "me rastin e prezantimit të faturës për pagesë, Operatori Ekonomik (OE) duhet që të sjell edhe pagesat e kontributeve të pensioneve për secilin punëtor të angazhuar, duke sjellë dëshmitë nga ATK-ja deri me datë 15 të muajit pasues".

Komuna përkatësisht menaxheri i kontratës kishte pranuar faturën tatimore nga OE pa situacion mbi sasi të dhe përshkrimin e materialit higjienik si informatë krahasimore me paramasën e kontraktuar. Njëkohësisht, ishte hartuar edhe raporti i pranimin të mallit. Megjithatë, OE nuk kishte ofruar dëshmitë mbi pagesën e kontributeve të punëtorëve të angazhuar në këtë projekt. Lëndën e pa kompletuar e kishte pranuar çertifikuesi dhe e njëjta ishte proceduar për pagesë. Vlera e pagesës është 8,145€.

Shkaku i ekzekutimit të pagesës me dokumentacion të mangët, ishte neglizhenca e menaxherit të kontratës dhe zyrtarit çertifikues, të cilët nuk e kishin ekzaminuar lëndën dhe të njëjtën ta kthenin për plotësim.

Ndikimi Ekzekutimi i pagesave në mungesë të dokumenteve burimore përkatësisht situacionit me specifikat e mallit të pranuar, rritë rrezikun e keqpërdorimit dhe mos ofrimit të mallit me specifikat e kërkuara në paramasën e kontraktuar.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se funksionojnë kontrollet tek menaxherët e kontratave dhe zyrtari çertifikues në mënyrë që asnjë pagesë të mos ekzekutohet në mungesë të dëshmive për mallrat apo shërbimet e pranuar krahas specifikave të kontraktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Anashkalimi i procedurave të prokurimit

Gjetja Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për prokurimin publik, përkatësisht nenit 2, paragrafi 2 "Ky ligj vlen për të gjithë personat, operatorët ekonomik, dhe ndërmarrjet, ashtu si përcaktohen këto terme në këtë ligj, që janë të përfshirë, marrin pjesë ose interesohen, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në aktivitete prokurimi të rregulluara me këtë ligj; nga personat e tillë, operatorët, dhe ndërmarrjet gjithashtu kërkohet që t'i respektojnë dhe të veprojnë në përputhje me kërkesat procedurale dhe materiale të këtij ligji.

Tek memorandumi i bashkëpunimit për promovimin e vlerave kulturore dhe tradicionale të komunës së Gjakovës, është nënshkruar memorandum bashkëpunimi me një produksion muzikor për sigurimin e shërbimeve, përkatësisht promovimin e vlerave kulturore e historike të komunës përmes video xhirimit të një kënge. Mirëpo, komuna nuk kishte aplikuar procedurat e prokurimit, vlera e memorandumit ishte 4,000€.

Mungesa e njohurive për të respektuar procedurat sikur parashihen me ligjin përkatës, ishte shkaku që zyrtarët nuk kishin inicuar procedurat e prokurimit.

- Ndikimi** Anashkalimi i procedurave të prokurimit, përveç që dëmtojnë konkurrencën, transparencën e procesit, efikasitetin dhe efektivitetin e veprimeve po ashtu rrisin rrezikun e mos arritjes së vlerës për paranë e shpenzuar dhe mundësisë së përballjes me vështirësi apo edhe humbje financiare të komunës.
- Rekomandimi A3** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se janë zbatuar procedurat e prokurimit për të gjitha furnizimet dhe shërbimet të cilat janë objekt i prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Pagesa mbi vlerën e lejuar të kontratës

- Gjetja** Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurim publik (RRUOPP) përkatësisht paragrafi 56.10 Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

Tek kontrata kornizë, "Sigurimi fizik i objekteve të komunës së Gjakovës" në vlerë 251,269€, komuna për të njëjtën kontratë kishte paguar për vitet 2018-2021 në vlerë prej 342,662€, duke tejkalluar vlerën e kontraktuar dhe vlerën indikativë +30%. Shuma e cila ishte tejkalluar është 16,012€.

Sipas zyrtarëve të komunës, domosdoshmëria e marrjes së shërbimit dhe procedurat e vonuara ankimore në OSHP për kontraktimin e shërbimeve, ka shtyrë që komuna të kryej pagesat për shërbimet të cilat ju ka skaduar kontrata me rastin e përmbushjes së vlerës kontraktuese.

- Ndikimi** Tejkalimi i limiteve të lejuara në kontratat kornizë ndikon në komplikime/vështirësi financiare të komuna, si dhe rrit rrezikun në mos realizimin e të gjitha projekteve të planifikuara.

Rekomandimi A4 Kryetari përmes Menaxherëve të kontratës dhe zyrës së prokurimit duhet të sigurohet që të mos lejoj tejkalime të pagesave për kontratat e përmbushura, sepse ç'do pagese mbi vlerat e kontraktuara me lejimet e aprovuara përbën shkelje ligjore dhe dëmtim i buxhetit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Dobësi në realizimin dhe menaxhimin e kontratës

Gjetja Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RrUOPP) Neni 61.20 paragrafi g dhe h, specifikon se “Funksionet e Menaxherit të Projektit janë: Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës; t'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta marr miratimin”.

Mangësitë e identifikuar në menaxhimin e kontratës janë si:

Tek kontrata “Furnizimi dhe montimi me ulëse për parqe, kontejnerëve të vegjël për mbeturina, kapak të puseta dhe ujëmbledhësve – grila” vlera 89,210€, komuna kishte ekzekutuar pagesën për pozicionet⁴ të cilat ishin ndryshuar por jo sipas paramasës së kontraktuar (pa tejkualuar vlerën totale të kontratës). Për këto ndryshime nuk ishin marrë aprovimet e nevojshme nga Zyra e prokurimit.

Sipas zyrtarëve të komunës, mungesa e njohurive nga ana e organit mbikqyrës, ka shtyrë që të ndryshohen pozicionet brenda paramasës së kontraktuar pa një aprovim nga zyra e prokurimit.

Ndikimi Ndryshimi i sasive të paramasës dhe parallogarisë së kontraktuar pa aprovimin e zyrës së prokurimit shpërfaq dobësitë në kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti i lartë.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik dhe se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit nga Zyra e prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Kryerja e pagesave për punë të përfunduara

Gjetja Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik pika 61.19 dhe 61.20, menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE, kryejn kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë dhe të siguroj që OE i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës.

Për projektin “Renovimi i Pallatit të Kulturës Cermjan Gjakovë”, në dy raste,

pagesat ishin realizuar për punët e pa kryera në vlerë 3,120€ si:

- Pjesa V instalimet makinerike-kaldatorja, pozicioni 1-"Furnizimi dhe montimi i kaldajave elektrike (3 copë) monoblok, ekuivalent me modeli 28KW". Sipas situacionit të nënshkruar nga organi mbikëqyrës, është realizuar pozicioni, ndërsa nga ekzaminimi fizik ky pozicion ishte i përealizuar, ku dy (2) kaldaja nuk ishin vendosur fare, kurse një (1) kaldajë e vendosur nuk ishte ekuivalent ose e ngjashme me modelin 28KW" (vlera e punëve të përealizuara ishte 3,000€); dhe
- Te pozicioni 2-"Furnizimi dhe montimi i valvolave sferike me holander 1". Sipas situacionit të nënshkruar nga organi mbikëqyrës është realizuar pozicioni, ndërsa nga ekzaminimi fizik ky pozicion ishte i përealizuar (vlera e punëve të përealizuara ishte 120€).

Për projektin "Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SH.M.E. Kadri Kusari - Gjakovë", vlera e pagesave për punë të përealizuara ishte 11,513€ si:

- Pozicioni 9.2 -"Furnizimi me material si dhe vendosja e granitit natyral t=2cm shkelëset dhe t=2cm balloret në hyrje të objektit, shkallët e jashtme dhe pllato rampat". Sipas situacionit të nënshkruar nga organi mbikëqyrës është realizuar pozicioni dhe janë vendosur 16.5m², ndërsa nga ekzaminimi fizik ky pozicion ishte i përealizuar (vlera e punëve të përealizuara 1,237€);
- Pozicioni 9.3 -"Furnizim me material si dhe montimi: Dyshemeja në sallën e sportit do të punohet nga Vinyli heterogjen si shtresë finale nga prodhuesi Tarkett apo ngjashëm, me karakteristika të njëjta". Sipas situacionit të nënshkruar nga organi mbikëqyrës është realizuar pozicioni dhe janë vendosur 500m², ndërsa nga ekzaminimi fizik ky pozicion ishte i përealizuar (vlera e punëve të përealizuara 10,000€); dhe
- Pozicioni 9.4 -"Furnizimi me material si dhe montimi i llajsneve nga materiali i njëjtë (të rekomanduara nga prodhuesi i dyshemesë – Tarkett në perimetër të kthinave. Salla sportive". Sipas situacionit të nënshkruar nga organi mbikëqyrës është realizuar pozicioni dhe janë vendosur 92 m², ndërsa nga ekzaminimi fizik ky pozicion ishte i përealizuar (vlera e punëve të përealizuara 276€).

Sipas zyrtarëve të komunës, shkak i realizimit të pagesave për punët e pa kryera të Renovimi i Pallatit të Kulturës- Cermjan Gjakovë" ishte se në të njëjtin objekt, kanë qenë duke operuar edhe firma të tjera, kurse te "Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SH.M.E. Kadri Kusari - Gjakovë" ishin kushtet atmosferike.

Ndikimi

Realizimi i pagesave për punët e pa kryera, ka dëmtuar buxhetin e komunës, po ashtu nuk është arritur qëllimi për zbatimin e plotë të projekteve.

Rekomandimi A6

Kryetari duhet të sigurojë që, përmes menaxherëve të kontratave, në raportin e pranimit, të përfshihen vetëm punët e realizuara, po ashtu, edhe pagesat të bëhen vetëm për punët e kryera.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Mungesa e projekteve ekzekutive**Gjetja**

Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) kërkon që "Specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten". Ndërsa pika 13 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohej që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në tre raste në kontratat: Ndërtimi dhe rrethimi i terreneve sportive (109,396€), Sanimi i trotuareve në Komunën e Gjakovës (86,927€) dhe Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve (147,393€), komuna nuk kishte hartuar projekt ekzekutiv, por kishte iniciuar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë.

Shkaku i mungesës së projekteve ekzekutive sipas zyrtarëve të komunës ishte mungesa e buxhetit për kontraktimin e një OE për hartimin e projekteve ekzekutive.

Ndikimi

Mungesa e projekteve ekzekutuese dhe inicimi i procedurave për projekte kapitale vetëm me paramasë dhe parallogari, rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi A7

Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A8 - Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara****Gjetja**

Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik, pikat 61.6, 61.19 dhe 61.20 përcaktojnë se: "Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Te Kushtet e veçanta të kontratës "Rrethimi dhe rregullimi i oborreve në shkollë" në vlerë 28,856€ dhe "Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zona rurale dhe sanimi, ndërtimi i pandave dhe kanaleve" në vlerë 59,999, neni 17.1, si dhe "Punimi i hartës zonale komunale" në vlerë 199,800€, neni 6.1. përcaktohet plani dinamik dhe data e përfundimit të të gjitha punëve, Nga pagesat e testuara për këto kontrata, kemi evidentuar vonesa deri në 270 ditë.

Sipas zyrtarëve komunal, shkaku i vonesave në punë ishte pandemia COVID-19, megjithatë, vonesat janë reflektuar edhe nga mungesa e kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Vonesat në kryerjen e punëve ndikojnë që objektivat e organizatës të arrihen me vonesë dhe mund të kenë implikime buxhetore për vitin vijues.

Rekomandimi A8 Kryetari duhet të sigurojë që, përmes menaxherit të prokurimit, si dhe menaxherëve të kontratave, se realizimi i kontratave bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat e parapara në kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Parregullsi lidhur me çmimet për njësi në ofertën tenderuese

Gjetja Rregulla dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik, përkatësisht pika 4.2.c. përcakton se gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, AK do të ketë obligim “të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut”. Po ashtu, pika 11.1.b. përcakton që zyrtari përgjegjës i prokurimit “siguron që mallrat, shërbimet dhe punët blihen në mënyrën më ekonomike, efikase dhe efektive”. Ndërsa, pika 13.2, në parashikimin e vlerës së kontratës, AK duhet: “të merren parasysh çmimet e publikuara nga Zyra e Statistikave të Kosovës dhe/ose çmime tjera indikative zyrtare (të tilla si zyra tatimore, zyra e doganave, oda ekonomike, etj); dhe/ose, çmimet e tregut lokal; dhe/ose, çmimet e kontratave paraprake të nënshkruara nga autoriteti i njëjtë apo tjetër kontraktuese; dhe/ose, çmime ndërkombëtare të publikuara; dhe/ose, çmimet për njësi të publikuara në webfaqe të KRPP-së.

Për projektin “Sanimi i trotuareve në Komunën e Gjakovës” (86,297€), në vitin 2021, komuna ka realizuar kontratën në vlerë 40,000€. Në rastin e ofertës së OE fitues, është identifikuar se, çmimet për pozicionet 2,3,4 dhe 8, kanë qenë jo normalisht të ulëta në krahasim me ato të parallogaritura në paramasë. Megjithatë komuna nuk ka kërkuar nga OE konfirmim për çmimet jo normalisht të ulëta. Në testimin e dy pagesave nga kjo kontratë është konstatuar se në pozicionet me çmimet jo normalisht të ulëta realizimi i sasive ishte i ulët.

A	Përshkrimi	Oferta e fituesit				Vlera e llogaritur nga paramasa		Audit diferenca	Realizimi sasi		Realizimi vlera
Nr.		Njësia Matese	Sasia	Çmimi për njësi me tvsh €	Çmimi total me TVSH	Çmimi për njësi me tvsh €	Çmimi total me TVSH		Pagesa 10,499.50€ dt. 20.10.2021	Pagesa 29,500.50€ dt. 06.10.2022	
			a	b	c=a*b	d	e=d*a	f=c-e	g	h	i=b*(g+h)
2	Gërmimi i gjërë i dheut (apo fraksioneve egzistuese) me makinë, ngarkimi dhe bartja deri në deponi. Llogaritet për m³ të pozicioni sipas përshkrimit.	m³	8,793.60	0.50	4,396.80	1.00	8,793.60	(4,396.80)	802.00	423.00	612.50
3	Blerja,furnizimi dhe shtruarja e gurit të thyer - çakull (0 - 61.5 mm) d=20cm me ngjeshje të duhur në shtresa deri te arritja e modulit të ngjeshmerisë dhe dendësisë, sipas normave teknike. Llogaritet për m³ të pozicionit në gjendje të ngjeshur.	m³	7,080.00	0.20	1,416.00	9.00	63,720.00	(62,304.00)	346.00	170.00	103.20
4	Blerja,transporti dhe shtruarja e gurit të thyer - çakull (0 - 31.5 mm) d=15cm me ngjeshje të duhur në shtresa deri te arritja e modulit të ngjeshmerisë dhe dendësisë, sipas normave teknike. Llogaritet për m³ të pozicionit në gjendje të ngjeshur.	m³	6,828.00	3.20	21,849.60	10.00	68,280.00	(46,430.40)	259.30	127.00	1,236.16
8	Blerja,transporti dhe shtruarja e kubëzave me trashësi t = 6.0 cm, të atestuar dhe certifikuar sipas ISO standardeve. Në çmim është llogaritur edhe shtruarja e shtresës rrafshuese me fr. II. Forma e kubëzave caktohet nga investitori.	m²	12,934.00	0.10	1,293.40	10.00	129,340.00	(128,046.60)	0.00	846.00	84.60

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i kujdesit jo të duhur nga ana e komisionit vlerësues dhe menaxherit të prokurimit, për të identifikuar çmimet jo normalisht të ulëta në ofertën e OE fitues.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar lidhur me çmimet jo normalisht të ulëta për pozicione në ofertën financiare tenderuese, mund të ndodhë që pozicionet e tilla të kontratës mos të realizohen apo të ndodhë shkëputje e kontratës. Po ashtu, kjo situatë reflekton negativisht në vlerësimin e saktë të kostos së projektit dhe në udhëheqjen e aktiviteteve të prokurimit në harmoni me parimet e konkurrencës, efikasitetit dhe efektivitetit.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë ritjen e kontrolleve të brendshme në procesin vlerësimit të drejtë të çmimeve të njësive në kuadër të ofertave tenderuese sipas çmimeve të përlogaritura në paramasë, apo edhe manualeve me çmimet referente për njësi të publikuara nga KRPP, çmimeve të tregut dhe çmimeve tjera indikative zyrtare. Gjithashtu Kryetari të siguroj se do të realizohet secili pozicion i kontratës me përpikëri.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore

Gjetja

Neni 40, për pagimin e vendimeve të prera gjyqësore, paragrafi 3 përcakton se pas pranimit të vendimit të plotfuqishëm ose urdhrat të formës së prerë, ministria është e autorizuar dhe ka përgjegjësinë që menjëherë të marr çfarëdo masa të nevojshme për pagimin e vendimit ose urdhrat nga ndarjet buxhetore në dispozicion.

Shpenzimet direkte të komunës përmes Thesarit ishin në vlerë prej 2,017,823€. Prej tyre 525,777€ ishin kosto shtesë për shpenzime gjyqësore. Nga 10⁶ mostrat e testuara në vlerë prej 1,480,992€ shpenzimet shtesë ishin 406,621€ sipas kategorive në vijim:

- Nga kategoria e Mallra dhe Shërbimeve, dy raste në vlerë prej 45,917€, prej tyre 5,887€ ishin kosto shtesë për shpenzime gjyqësore, përmbartimore dhe të interesit;
- Nga kategoria e Pagave dhe Mëditjeve, pesë raste në vlerë prej 1,320,700€, prej tyre 387,361€ ishin kosto shtesë për shpenzime gjyqësore, përmbartimore dhe të interesit;
- Nga kategoria e Investimeve kapitale, dy raste në vlerë prej: 82,924€, prej tyre 6,421€ ishin kosto shtesë për shpenzime gjyqësore, përmbartimore dhe të interesit; dhe
- Nga kategoria e Subvencioneve dhe transfereve, një rast në vlerë prej 31,451€, prej tyre 6,951€ ishin kosto shtesë për shpenzime gjyqësore, përmbartimore dhe të interesit.

Kjo ka ndodh si rezultat i mos pagesës me kohë të obligimeve financiare dhe kërkesave për paga jubilarë ku pjesa më e madhe ishte për shujta dhe transport për implementimin e kontratës kolektive, si dhe pagesave ndaj furnitorëve.

Ndikimi	Pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve respektivisht implementimin e projekteve, po ashtu krijojnë kosto shtesë në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe interesit.
Rekomandimi B2	Kryetari duhet të sigurojë planifikimin e drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda planifikimeve buxhetore dhe afateve kohore të përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja	Sipas nenit 39.1 të Ligjit nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kërkohet që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës. Në gjashtë raste/fatura⁷ në vlerë totale prej 169,149€ pagesat nuk ishin bërë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat janë nga 71 deri 1,442 ditë kalendarike. Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve është planifikim jo i mirë i buxhetit dhe iniciimi i procedurave të shpenzimeve pa mjete në dispozicion.
---------------	--

Ndikimi	Detyrimet e bartura rrisin rrezikun në mos realizimin e projekteve dhe në mos arritjen objektivave të komunës. Si rezultat i nevojës për t'i paguar (obligimet) zotimet e viteve paraprake, njëherit kjo ndikon edhe në kosto shtesë në rast të padive nga furnitorët.
----------------	--

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë planifikim të buxhetit adekuat si dhe që, iniciimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të detyrimeve ndaj OE-ve. Gjithashtu, Kryetari duhet siguroj që të kryhen të gjitha detyrimet e viteve paraprake.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Kontrollët e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja A9 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në kategoritë ekonomike jo adekuate në vlerë prej 52,177€, si në vijim:

- Nga kategoria ekonomike mallrat dhe shërbimet janë planifikuar dhe realizuar pagesa në vlerë prej 37,987€ të cilat për nga natyra ishin investime kapitale vlera 27,742€ dhe subvencione vlera 10,245€.
- Nga kategoria ekonomike investime kapitale janë planifikuar dhe realizuar pagesa në vlerë prej 14,190€ të cilat për nga natyra ishin mallra dhe shërbime në vlerë 1,394€ dhe subvencione në vlerë 12,796€.

Këto kishin ndodhur për shkak të planifikimit jo të mirë buxhetor dhe mungesës së mjeteve në kategoritë adekuate.

Ndikimi

Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpjen në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të Komunës, dhe si të tilla japin informata jo të sakta për shfrytëzuesit e PFV-ve.

Rekomandimi A9

Kryetari duhet të sigurojë që, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestnimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A10 - Mungesa e kontrolleve në përgatitjen e Draft Pasqyrave Financiare Vjetore

Gjetja

Përgatitja e PFV-e duhet të bazohet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme si dhe sipas Rregullores së MFTP nr.01/2017 për Raportimin Vjetor Financiar të Organizatës buxhetore. Komuna ka përgatitur dhe dërguar në Thesar PFV-të sipas afatit të paraparë deri me 30 janar. Megjithatë me rastin e rishikimit të PFV-e, nga ana e auditimit, janë vërejt disa çështje të cilat i kemi rekomanduar Komunës për korrigjim.

Çështjet e identifikuar janë:

Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit – tek pjesa dalja e parasë se gatshme të shtylla Buxheti Final tek shënimi 2 kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje është prezantuar 15,414,000€ ndërsa sipas SIMFK ishte 15,814,282€.

Pasqyra 2 neni 14 i Raporti i ekzekutimit të buxhetit pjesa hyrja e pras ne LLVTH shënimi nr 8 te hyrat tatimore buxheti final është prezantuar me vlerë 2,092,000€ ndërsa sipas Buxhetit ishte 1,729,530€.

Pasqyra 2 neni 14 i Raporti i ekzekutimit të buxhetit pjesa hyrja e pras ne LLVTH shënimi nr. 9 te hyrat Jo tatimore buxheti final është prezantuar me vlerën 1,937,000€ ndërsa sipas Buxhetit ishte 1,648,728€.

Tek neni 14, Raportimi i ekzekutimit të buxhetit të shtylla realizimi shënimi 12 nuk është paraqitur të hyrat nga viti i kaluar nga Kodi Ekonomik 61000 në vlerë 912 euro.

Neni 21 Raport për të hyrat vetanake të pashpenzuara- te hyrat vetanake te pranuar gjatë viti 2021 janë prezantuar në vlerë prej 4,582,361€, ndërsa vlera ishte 4,782,145€.

Me rekomandim të auditorëve, PFV-të janë korrigjuar në afatin ligjorë.

Kjo kishte ndodh për shkak të kontroleve të brendshme jo të mjaftueshme dhe kujdesit të mangët të stafit përgjegjës në përgatitjen e PFV-ve.

Ndikimi

Paraqitja jo e drejtë dhe e saktë e të dhënave në PFV, jep një pasqyrim jo të plotë për shfrytëzuesit e PFV-ve. Si pasojë, referuar në PFV, kjo mund të ndikojë edhe në marrjen e vendimeve të gabuara nga vetë Komuna apo shfrytëzuesit e sajë.

Rekomandimi A10

Kryetari duhet të sigurojë që përmes personave përgjegjës, që gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare Vjetore për vitin 2022, ti kushtohet vëmendje që mos të kenë gabime kontabël dhe administrative.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara në 2021 ishin në vlerë 4,154,591€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, participimet etj. Përveç të hyrave vetanake, komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror në vlerë prej 466,624€ (gjatë vitit 2021 ka inspektuar vetëm 1,642 prej tyre, apo 5%).

Çështja A11 - Dobësi në procesin e veprimtarive inspektuese të pronave

Gjetja	Sipas nenit 15.2 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës. Komuna për vitin 2021 nuk ka arrit të kryej inspektimin e 20% të pronave të regjistruara, ku prej 34,232 të pronave, gjatë vitit 2021 ka inspektuar vetëm 1,642 prej tyre, apo 5%. Kjo ka ndodhur si rezultat i menaxhimit jo efikas të veprimtarive inspektuese, derisa sipas komunës kjo është nga ndikimi i pandemisë COVID-19.
Ndikimi	Verifikimi jo i plotë i pronave për qëllime të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.
Rekomandimi A11	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të organizmit të veprimtarive inspektuese sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në mënyrë që ndryshimet eventuale nga inspektimet të jenë regjistruar, ashtu që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Vonesa në shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve

Gjetja	Bazuar në nenin 31 pika 6 të Ligjit nr.06L/005 për Tatimin në pronën e paluajtshme – “Komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë, deri në tridhjetë ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar, me një vendim të arsyetuar”. Nga gjithsej 340 ankesa të shqyrtuara nga komuna, në 58 raste ku tatimpaguesit kanë bërë ankesë lidhur me pasaktësinë e faturës së tatimit në pronë, shqyrtimi i tyre është bërë me vonesë, duke tejkaluar afatin ligjor për shqyrtim nga një deri në tre muaj. Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i gjendjes së pandemisë COVID-19 në vend, gjatë së cilës komuna ka operuar me staf të reduktuar.
Ndikimi	Mos azhurnimi i informatave dhe vlerësimi jo i duhur i pronave në bazën e të dhënave të tatimit në pronë mund të vështirësoj inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë dhe njëherësh ndikon në rritjen e llogarive të arkëtueshme si pasojë e pakënaqësisë dhe ankesave të qytetarëve.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet sigurojë se, shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve bëhet brenda afateve ligjore. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet për vlerësim të saktë të tatimit në pronë për taksapaguesin.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 663,154€, prej tyre ishin shpenzuar 591,454€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me financimin e OJQ-ve për projekte sportive dhe kulturore, financimin e granteve për të rinjë dhe përfituesve individualë.

Çështja A12 - Mungesa e planit vjetor për financimin publik të OJQ-ve

Gjetja	Sipas nenit 6 të Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve (Plani Vjetor i Mbështetjes Financiare) kërkohet: “Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit”. Komuna edhe pse me Buxhet të Republikës së Kosovës ka parapa që gjatë vitit 2021 të ofrojë mbështetje financiare për projektet dhe programet e OJQ-ve, megjithatë nuk ka përmbushur kërkesën ligjore për përgatitjen e Planit Vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve. Shkak i kësaj ishte neglizhenca e zyrtarëve kompetent për përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare.
Ndikimi	Mos përgatitja e planit vjetor rritë rrezikun që mjetet buxhetore të shfrytëzohen për qëllime tjera të paplanifikuara dhe në mos arrihen e objektivave të komunës në këtë fushë.
Rekomandimi A12	Kryetari duhet të sigurojë se, drejtoritë përkatëse përgatisin plan vjetor për subvencionim të OJQ-ve, ku ndarja e buxhetit bëhet në përputhje me objektivat e përcaktuara dhe të dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit duke respektuar kriteret e rregullores për subvencionim të OJQ-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 76,019,405€, pasurive jokapitale është 1,705,745€, si dhe e stokeve 182,317€.

Çështja B5 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja

Rregullorja 02/2013 për menaxhimin e Pasurive jo financiare nenit 22 pika 1 - zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtvizore. Po ashtu, sipas nenit 18 pika 3 - Organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare dhe një aktivitet tjetër që i paraprinë inventarizimit është se komuna duhet nxjerr udhëzim të brendshëm sipas nenit 19 pika 5.

Te pasuria kapitale mbi 1000€, në 12 mostra të testura (automjete të cilat i takojnë periudhave që nga viti 2001-2007) figurojnë në regjistrin e pasurisë me vlerën e tyre fillestare në total prej 34,357€. Ndonëse vlera neto në libra do duhej të ishte zero. Kjo gjendje është rezultat i vendosjes së të dhënave fillestare në SIMFK në mënyrë të gabuar pa iu përcaktuar norma e zhvlerësimit dhe mos rishikimit të vazhdueshëm të tyre nga procesi i brendshëm i kontrollit.

Me tutje procesi i inventarizimit të pasurive jo financiare nuk ishte përfunduar sipas kërkesave të Rregullores 02/2013. Kryetari ka emëruar komisionin e inventarizimit me dt.28.01.2022 i cili nuk ka arritur të kryej inventarizimin e pasurisë jo financiare për vitin 2021. Gjithashtu në mungesë të raporteve nga komisioni inventarizimit, edhe komisioni vlerësimit edhe pse i themeluar nuk ka ndonjë raport të vlerësimit.

Shkaku i mungesës së raportit të inventarizimit ishte vendimi i vonshëm për themelimin e këtij komisioni, gjithashtu kjo ka ndikuar edhe në punën e komisionit të vlerësimit.

Sipas zyrtarëve komunal, neglizhenca nga zyrtarët përgjegjës për SIMFK në Ministrinë e Financave lidhur me evitimin e gabimit për vendosjen e normave të zhvlerësimit, ka bërë që gjendja në fjalë të jetë e njëjtë edhe këtë vit.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar lidhur me mos përfundimi i inventarizimit dhe mos zhvlerësim, ndikon që prezantimi i pasurisë në regjistrat e komunës dhe pasqyrat financiare vjetore të mos jetë i saktë dhe i plotë dhe rrezikon humbjen apo përvetësimin e pasurisë në mënyrë të paligjshme.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive të kryhet sipas kërkesës së Rregullores 02/2013, dhe korrigjimi i vlerës neto të pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 10,734,153€. Kjo vlerë përbehet tatimi në prone 9,785,105€, qirat e dyqaneve 50,023€, qiratë e tokave 330,364€, taksa në firmë 568,661€

Çështja B6 - Rritje e llogarive të arkëtueshme

Gjetja	Bazuar në neni 27 të Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe neni 16 të Rregullores për Taksa Tarifa, Ngarkesa dhe Shërbimet Komunale, ku përcaktojnë mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara duke përdorur masat e mbledhjes së detyrueshme. Dhe neneve 1,3 dhe 4 të Ligjit nr.06/L092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe në nenin 5 të kontratës për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale ku specifikohet se deri me datën 05 të secilit muaj duhet të kryhet pagesa nga ana e shfrytëzuesit të pronës. Llogaritë e arkëtueshme në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 kishte rritje për 421,323€, veçanërisht të ndërmarrjet shoqërore (tatimi në pronë) dhe taksa në firmë (bastoret). Komuna përveç dërgimit të letër kujtesave, nuk ka bërë përpjekje tjera (ngritje të padis apo procesit përmbarimorë) për inkasimin e mjeteve të pa arkëtuara qoftë nga tatimi në pronë, qiratë nga toka, dyqanet, tregjet apo taksat në firmë. Sipas Komunës, kjo ka ndodhur si shkak i pamundësisë se veprimit të komunës në mbledhjen e të arkëtueshmeve ndaj ndërmarrjeve shoqërore dhe situata pandemike COVID-19.
Ndikimi	Mos arkëtimi i të hyrave të ngarkuara ndikon në pamundësinë e komunës për t'i përmbushur planet e shpenzimeve dhe po ashtu mund të rezultojë në vështirësi të mëtutjeshme në arkëtimin dhe vjetërsimin e të arkëtueshmeve deri në shndërrimin e tyre në borxh të keq.
Rekomandimi B6	Kryetari duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e të arkëtueshmeve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.6 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2021 ishte 567,568€. Në këtë vlerë përfshihen vetëm vendimet përmbartimore lidhur me kontestet e ndryshme si: Kompensime për profite të humbura, kompensim prone, vërtetim pronësie etj.

Çështja B7 - Llogari jo e plotë e detyrimeve kontingjente në pasqyra financiare

- Gjetja** Sipas Rregullores MF nr. 01/2017, Neni 3 1.1. Detyrim kontingjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen; dhe Neni 18 Organizatat buxhetore në harmoni LMFP raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.
- Komuna nuk posedon një regjistër të plotë të të gjitha pretendimeve të palëve të jashtme ndaj komunës. Proceset gjyqësore të drejtorisë së Arsimit dhe Shëndetësisë nuk janë të përfshira në regjistrin e detyrimeve kontingjente.
- Kjo ka ndodhur si rezultat i mos krijimit të një regjistri të përgjithshëm i cili do duhej të azhurnohej dhe mirëmbahej ndër vite lidhur me detyrimet kontingjente nga zyra ligjore në komunë.
- Ndikimi** Mos prezantimi i plotë i detyrimeve kontingjente shkakton nënvlerësim të tyre dhe për pasoj mos planifikimin e duhur të buxhetit për mbulimin e detyrimeve financiare në vitin pasues në rast të humbjes së këtyre kontesteve.
- Rekomandimi B7** Kryetari duhet të sigurojë një sistem të mirëfilltë të kontrollit në mënyrë që të krijohet dhe mirëmbahet regjistri i përgjithshëm i detyrimeve kontingjente në mënyrë që raportimi i tyre të jetë i saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.7 Funkcioni i auditimit të brendshëm

Komuna e Gjakovës ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NJAB) me të cilin operon vetëm udhëheqësi i njësisë. Gjithashtu, është i themeluar komiteti i auditimit i cili përbëhet nga katër anëtar i cili ka mbajtur katër takime në vitin 2021. NJAB kishte dhënë rekomandime se si menaxhmenti të përmirësojë funksionimin e kontrollit të brendshëm ku kishte përfunduar tre (3) auditime të rregullta aq sa ishin planifikuar me planin vjetor dhe një auditim me kërkesë. Në këto raporte janë dhënë nëntë (9) rekomandime, prej tyre katër (4) janë zbatuar dhe pesë (5) ishin në proces.

Çështja B8 - Dobësi në fushën e auditimit të brendshëm

Gjetja	Rregullorja (QRK) nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik neni 5, pika 1 kërkon që “udhëheqësi i subjektit të sektorit publik themelon Njësinë e pavarur të auditimit të brendshëm sipas këtyre kritereve: 1.1 Subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë milionë euro të ketë së paku tre auditorë të brendshëm”. NJAB kishte vetëm një auditor dhe nuk ka arritur t'i mbulojë të gjitha fushat me rrezik si: menaxhimi i pasurisë, menaxhimi i kontratave të pronave të dhëna në shfrytëzim, llogaritë e arkëtueshme dhe pagueshme, detyrime kontingjente etj. Auditori brendshëm kishte përcaktuar fushëveprimin në mënyrë të përgjithësuar duke mos saktësuar periudhat kohore për të cilat realizohet auditimi. Kjo ka ndodhur për shkak të burimeve të pamjaftueshme në auditimin e brendshëm në komunë.
Ndikimi	Burimet e pamjaftueshme të NJAB ndikon negativisht në përmirësimin e sistemeve të kontrollit në komunë dhe në arritjen e objektivave të saj.
Rekomandimi B8	Kryetari duhet të rishikoj performancën e NJAB dhe sipas nevojës dhe mundësisë financiare dhe buxhetore të ndërmerr veprime për shtimin e kapaciteteve njerëzore brenda NJAB.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^a	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	26,330,580	29,140,628	27,459,229	27,339,931	25,626,846
Grante Qeveritare – Buxheti	22,952,322	23,948,011	23,695,818	23,077,882	20,769,699
Financimi përmes huamarrjes	0	96,143	96,003	228,259	48,173
Të bartura nga viti i kaluar	0	960,009	621,817	1,013,578	1,533,053
Të hyrat vetanake	3,378,258	4,028,258	3,004,022	2,602,543	2,978,144
Donacionet vendore	0	81,526	30,946	13,995	2,762
Donacionet e jashtme	0	26,681	10,624	403,675	295,015

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 2,810,048€. Kjo rritje është rezultat i pranimit të buxhetit nga donacionet, të hyrave të bartura nga viti paraprak, huamarrja dhe rimëkëmbja. Në vitin 2021 komuna ka shpenzuar 94% të buxhetit final, me një rritje prej 1% në krahasim me vitin 2020. Zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	26,330,580	29,140,628	27,459,229	27,339,931	25,626,846
Pagat dhe mëditjet	14,150,978	15,814,282	15,812,416	14,242,133	13,599,828
Mallrat dhe shërbimet	3,240,000	3,407,829	3,258,299	3,687,338	2,834,453
Komunalitë	586,800	610,595	561,203	532,670	579,693
Subvencionet dhe transferet	550,500	663,154	591,454	682,271	482,644
Investimet Kapitale	7,337,302	8,644,767	7,235,857	8,195,520	8,130,229
Rezervat	465,000	0	0	0	0

• Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar në total ishte rritur për 1,663,304€. Kjo rritje ishte sipas rishikimit të buxhetit dhe vendimeve të qeverisë në shumë prej 1,606,339€ (ku 560,840€ për paga shtesë për COVID-19 dhe 1,045,499€ për pagesat e përmbaruesve për paga jubilarë dhe pagesat e shujtave dhe transportit të profesorëve). Ndërsa rritja nga granatet e përcaktuara të donatoreve ishte 6,554€ dhe financimi nga huamarrja 64,868€. Po ashtu, kishte zvogëlim me vendim të qeverisë prej 14,457€ për kalimin e inspektorëve komunal në Agjencinë e Veterinës së Kosovës.

• Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 167,829€, kjo rritje ishte sipas rishikimit të buxhetit prej 2,944€ vendimeve të Qeverisë 97,056€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar 52,065€, granateve të përcaktuara të donatoreve 12,820€ dhe financimi nga huamarrja 5,344€, po ashtu, me vendim qeverisë kishte zvogëlim prej 2,400€.


• Buxheti final për shërbimet komunale ishte rritur për 23,795€ si rezultat i të hyrave të batuara nga viti i kaluar.

• Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 112,654€, si rezultat i rishikimit të buxhetit në shumë 71,000€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar 38,695€ dhe granateve të përcaktuara të donatorëve 2,959€.

• Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,307,465€, kjo rritje ishte sipas vendimeve të qeverisë në shumë prej 324,276€ dhe rishikimit të buxhetit prej 25,931€, të cilat janë bartur nga rezervat (350,207€), të hyrave të batuara nga viti i kaluar në shumë prej 845,454€, granateve të përcaktuara të donatorëve 85,873€ dhe financimi nga huamarrja 25,931€.

• Buxheti final për rezerva në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 465,000€ buxhet i cili ka kaluar në kategori tjera me vendime dhe rishikim të buxhetit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Gjakovës në 2021 ishin në vlerë 4,115,649€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, participimet etj. Përveç këtyre të hyrave komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror në vlerë prej 466,624€ (gjobat në trafik 32,312€ dhe të hyrat nga gjykata në vlerë prej 434,312€, këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministrinë e linjës dhe gjykata.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	3,378,258	3,378,258	4,115,649	2,919,388	3,328,410
Të hyrat tatimore	1,729,530	1,729,530	2,313,597	1,411,815	1,686,810
Të hyrat jo tatimore	1,648,728	1,648,728	1,801,140	1,507,572	1,641,600
Të hyrat tjera	0	0	912	0	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 ka rezultuar me 10 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, dy (2) rekomandime janë zbatuar; tetë (8) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikun 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve bëhet brenda afateve ligjore. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të siguroj se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për taksapaguesin.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Investimet kapitale	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin vlerësimit të drejtë të çmimeve të njërive në kuadër të ofertave tenderuese sipas çmimeve të përlllogaritura në paramasë, apo edhe manualeve me çmimet referente për njësi të publikuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, çmimeve të tregut dhe çmimeve tjera indikative zyrtare. Gjithashtu Kryetari të siguroj se do të realizohet secili pozicion i kontratës me përpikëri.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Investimet kapitale	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se do të aplikohet konfiskimi i sigurisë së tenderit në rastet kur operatorët ekonomik	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	I zbatuar

		tërhiqen apo nuk përgjigjen për të plotësuar kërkesën mbi përshtatshmërinë. Konfiskimi i sigurisë së tenderit për ofertuesit e papërgjegjshëm zvogëlon mundësin e pjesëmarrjes së ofertuesve joserioz.		
4.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë planifikimin e drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda planifikimeve buxhetore dhe afateve kohore të përcaktuara.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar vlerësimi
5.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të siguroj se kontrollet janë funksionale në menaxhimin e procesit të vlerësimit të tenderëve, në mënyrë që ky proces të jetë i drejtë dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe të mos eliminohen operatorët ekonomik të përgjegjshëm me ofertën me të leverdishme ekonomike.	Janë ndërmarrë veprime	I zbatuar
6.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj përzgjedhjen e anëtarëve kompetent në komisionin e inventarizimit dhe të nxjerr një udhëzues të brendshëm për inventarizimin e pasurisë duke sqaruar mandatin e plotë dhe të saktë të tij sipas rregullores për menaxhimin e pasurisë jofinanciare. Gjithashtu të ndërmerr masa në korrigjimin e vlerës neto në libra të 12 aseteve dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike e cila ka kontratë direkte me mirëmbajtësit e softuerit të e-pasurisë të mundësoj sanimin e defekteve në sistem në mënyrë që regjistri i pasurisë jokapitale të mund të azhurnohet dhe gjenerohet me kohë, para hartimit të PVF për vitin 2021.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatim
7.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e të arkëtueshmëve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të llogarive të arkëtueshme.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim
8.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të shtoj kujdesin për një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të detyrimeve ndaj OE-ve. Gjithashtu, Kryetari duhet siguroj që të kryhen të gjitha detyrimet e viteve paraprake.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim
9.	Detyrimet Kontingjente	Kryetari duhet të siguroj një sistem të mirëfilltë të kontrollit në mënyrë që të krijohet dhe mirëmbahet regjistri i përgjithshëm i detyrimeve kontingjente dhe llogaria e tyre të prezantohet e plotë dhe e saktë në PVF.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim

10.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të rishikoj performancën e NJAB dhe sipas nevojës dhe mundësisë financiare dhe buxhetore të ndërmerr veprime për shtimin e kapaciteteve njerëzore brenda NJAB.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme	Nuk ka filluar zbatimi
-----	----------------------	---	---	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Fanol Hodolli, Udhëheqës i ekipit



Arian Zenelaj, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjakovës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe:
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Sinqerisht,

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

Data: 23.05.2022



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹⁰ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹¹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Vendimi 01Nr.400/05-20825/2021; Vendimi 01nr.400/05-13450/2021; Vendimi 01nr.400/04-12349/2018 i datës 30.04.2018 sipas kërkesës së klubit e protokulluar në Komunë me nr. 01-0400/04 datë 23.03.2018.
- ⁵ (Poz. Nr 1.1, 1.2, 2.1 dhe 2.2).
- ⁶ Mallra dhe shërbime: Vendim gjyqësor për KRU Gjakova në vlerë 8,034,20€ dhe për KRU Radoniqi në vlerë 37,883.15€. Paga dhe Mëditje - Vendim gjyqësor për paga jubilarë dhe shujtave etj. 122,400,90€, 199,498.00€, 105,652.40€, , 131,175.00€, 761,973.79€. Investime kapitale - Vendim gjyqësor 37,667,94€ dhe 45.279,79€. Subvencione dhe transfere – Vendim Gjyqësore për detyrimet ndaj klubit të sportit 31.451,27€.
- ⁷ Hartimi i projekteve të ndërtimit të ulet në vlerë 17,741.49€; Rregullimi i shtratit të lumit Krena në vlerë 100,000€; Obligimet e pa paguara "Victoria Invest" Nr. Faturës 05/SHQ/2019 në vlerë 2.054.43€; Obligimet e pa paguara "Euroasphalt" Nr. Faturës 03/2018 në vlerë 5,660.89€; Obligimet e pa paguara "Joos-Krasniqi" Nr. Faturës 17/20 në vlerë 8,429.72€; Obligimet e pa paguara "Euroasphalt" Nr. Faturës 149/21 në vlerë 35,262.49€
- ⁸ NJAB kishte kryer gjithsej tri auditime sipas planit dhe një auditim me kërkesë: Auditimi I dhenjes se granteve nga drejtoria per zhvillim ekonomik, Auditimi i menagjimit te kontrtave ne drejtorine e sherbimeve publike dhe Auditimi i procesit te prokurimit, Auditimi I projektit nga MPJ e qeverise se Bullgarise
- ⁹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹⁰ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹¹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.